

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Elite Motors” SHPK

Sot, më datë 01.09.2025 (Dymijë e njëzet e pesë), ortakët themelues:

1. **Z. Hamza Vogli** -shtetas shqiptar, i biri i Samirit, lindur në Kavajë, i datëlindjes 21.09.2004, me banim në adresën: Rruga Cen Cela, Arrëmeras Fushë Krujë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal K40921096E.
2. **Z. Omar Xibri** -shtetas shqiptar, i biri i Albanit, lindur në Tiranë, i datëlindjes 06.06.2005, me banim në adresën: Rruga Musa Agolli, Nd.13, Hyrja 14, Ap. 8, kodi postar 1017, Njesia 8, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal K50606042P.
3. **Z. Krivis Pasholli** -shtetas Shqiptar, i biri i Fisnikut, lindur në Tiranë, i datëlindjes 05.05.2004, me banim në adresën: Rruga 4 Dëshmorët, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal K40505056W.

Kanë vendosur themelimin e shoqërisë “Elite Motors” SHPK me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Elite Motors” SHPK themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2. Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “Elite Motors” SHPK.

NENI 3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt ushtrimin aktivitetit :

Import - export, shitje dhe blerje të automjetëve të çdo lloji, pjesë këmbimi dhe aksesore. Shoqëria, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek lejet, licencat, aprovimet apo autorizimet e tjera të ligjshme të lëshuara nga institucionet qeveritare kompetentë të fushës.

NENI 4 Selia e Shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: **Rruga “Musa Agolli”, Nd.13, Hyrja 8, kodi postar 1017, Njesia 8, Tiranë.** Adresa e selisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 5. Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë.

ELITE MOTORS
AKT THEMELIMI

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 300,000

(Treqindmijë) Lekë, i ndare në **1(një)** kuotë .

Ortakët themelues të shoqërisë, i zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

- **Hamza Vogli** – Zotërues i 33.34% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100,000 (Njëqindmijë) lekë.
- **Omar Xibri** – Zotërues i 33.33% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100,000 (Njëqindmijë) lekë.
- **Kravis Pasholli** – Zotërues i 33.33% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100,000 (Njëqindmijë) lekë.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortakët themelues. Vlera dhe pagesa e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij statuti dhe aktit të themelimit.

NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

Neni 7. Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administrator i pare i shoqërisë do të jetë Omar Xibri - shtetas shqiptar, i biri i Albanit, lindur në Tiranë, i datëlindjes 06.06.2005 me banim në adresën: Rruga Musa Agolli, Nd.13, Hyrja14, Ap. 8, kodi postar 1017, Njesia 8, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal K50606042P.
me një mandat 5 (pesë) vjeçar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

ELITE MOTORS
AKT THEMELIMI



NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12. Legjislacioni i aplikuar

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakët themelues dhe i vulosur përpara notërit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 13. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14. Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

1. Hamza Vogli

Hamza Vogli 

2. Omar Xibri

Omar Xibri 

3. Krivis Pasholli

Krivis Pasholli 